



**PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN
E MATURËS SHETËRORE PROFESIONALE 2015**

TEORIA PROFESIONALE:

DREJTIMI MËSIMOR “ELEKTROTEKNIKË”

Janar, 2015

1. Udhëzime të përgjithshme

Ky program orientues ndihmon në përgatitjen e nxënësve të drejtimit “**Elektroteknikë**”, me strukturë 2+1+1, për provimin me zgjedhje të detyruar “Teori profesionale e integruar” të Maturës Shtetërore Profesionale 2015. Ai synon orientimin e përgatitjes së nxënësve nëpërmjet përqendrimit në njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të lëndëve teorike profesionale. Njëherazi, ndihmon edhe në verifikimin paraprak të përgatitjes përfundimtare të nxënësve sepse mundëson zhvillimin e testimeve përmbledhëse. Programi orientues për provimin e “Teorisë profesionale të integruar” bazohet në:

- programet orientuese për Provimet Përfundimtare në: drejtimin “Elektroteknikë”, Niveli I dhe “Elektroteknik i kombinuar (pilot-PEM)”, Niveli I; në profilin “Instalime elektrike civile dhe industriale”, Niveli II, “Instalim dhe mirëmbajtje e TU dhe TL”, Niveli II, “Riparim i pajisjeve elektroshtëpiake”, Niveli II dhe në profilin “Elektromekanik”, Niveli II;
- programet e lëndëve teorike profesionale të drejtimit “Elektroteknikë”, Niveli III (klasa e 13-të);
- Udhëzimin e përbashkët të MAS dhe MMSR nr. 2, datë 06.02.2015 “Për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale 2015 në Republikën e Shqipërisë”.
- Rregulloren e Maturës Shtetërore 2015 në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhërin e Ministrit nr. 61, datë 10.02.2015.”.

Në të përfshihen njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të këtyre programeve dhe që janë në themel të formimit teorik profesional të nxënësit.

2. Udhëzime për zbatimin e programit

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes sepse evidenton dhe përforcon njohuritë teorike, por dhe aftësitë e nxënësve për aplikimin e njohurive në situata të njohura e të reja, analizën dhe vlerësimin e këtyre situatave. Specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të kësaj lënde, nuk duhet të përfshijnë për vlerësim tema mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program. Përgatitja e nxënësve për provim të bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe duke përdorur një larmi metodash dhe mjetesh.

Gjatë punës për përgatitjen e nxënësve për provimin me zgjedhje të detyruar “Teori profesionale të integruar ” të Maturës Shtetërore Profesionale, është e rëndësishme që herë pas here mësuesi të zhvillojë teste të nxënësve të tij, me teste që mund t’i hartojë vetë duke u bazuar në modelet e mëparshme të testeve të Maturës Shtetërore për teorinë profesionale.

Testi për drejtimin mësimor **“Elektroteknikë”** do të ndërtohet në mënyrë të tillë ku të jenë të përfshira të tri nivelet e vështirësisë: niveli bazë, niveli mesatar dhe niveli i lartë. Njëkohësisht, edhe shpërndarja e pikëve në test do të jetë në varësi të përqindjeve që zë çdo nivel. Gjatë hartimit të njësive të testit duhet të mbahen parasysh synimet e përgjithshme, në skeletkurrikulat përkatëse, të temave të përzgjedhura në këtë program.

Nxënësit duhet të kenë parasysh se lënda, e cila ka peshën më të madhe në këtë program orientues të Maturës Shtetërore Profesionale, në test do të përfaqësohet nga një numër më i madh pyetjesh.

3. Lëndët dhe temat përkatëse

Në programin orientues të provimit të **“Teorisë profesionale të integruar”** në kuadrin e provimit me zgjedhje të detyruar **“Teori profesionale e integruar”**, të Maturës Shtetërore Profesionale, për drejtimin mësimor **“Elektroteknikë”**, do të përfshihen programet e lëndëve profesionale të mëposhtëme:

1. Teknologji elektrike, kl.10 dhe 11 si dhe Bazat e teknologjisë elektrike, kl.10.
2. Elektroteknikë dhe matje, kl. 10 dhe kl. 11.
3. Elektronikë, kl. 10 dhe Bazat e elektronikës, kl. 11.
4. Makinat elektrike, kl. 11.
5. Bazat e sipërmarrjes, kl. 12 dhe kl. 13.
6. Elektroteknikë dhe matje e thelluar, kl. 13.
7. Elektronikë industriale, kl. 13.
8. Administrim dhe ligjshmëri në elektroteknikë, kl. 13
9. Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm, kl. 13.

Tabela 1: Lëndët dhe peshat përkatëse në programin orientues

Nr	Lënda	Vëllimi i orëve për çdo lëndë	Peshat në %
1	Teknologji elektrike dhe Bazat e teknologjisë elektrike	34	13
2	Elektroteknikë dhe matje	32	12
3	Elektronikë dhe Bazat e elektronikës	24	9
4	Makinat elektrike	40	15
5	Bazat e sipërmarrjes	19	8
6	Elektroteknikë dhe matje e thelluar	50	19
7	Elektronikë industriale	20	8

8	Administrim dhe ligjshmëri në elektroteknikë	28	11
9	Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm	14	5
	TOTALI	261	100%

Temat sipas lëndëve janë:

- a) **“Teknologji elektrike”, kl. 10 dhe 11 dhe “Bazat e teknologjisë elektrike”, kl.10: (34 orë)**
- Njohuri mbi ndriçimin elektrik 6 orë
 - Materialet përcjellëse dhe izoluese të elektricitetit 6 orë
 - Burimet elektrike të dritës dhe karakteristikat e tyre 8 orë
 - Skemat e ndriçimit dhe llogaritja e tyre (Ndërtimi i një projekti ndriçimi elektrik për lokale të mbyllura) 6 orë
 - Njohuri mbi cos Ø dhe metodat e përmirësimit të saj 8 orë
 - Zgjedhja e përcjellësave dhe kablove sipas kushteve të ngrohjes 6 orë
- b) **“Elektroteknikë dhe matje”, kl.10 dhe kl.11: (32 orë)**
- Qarqet e thjeshta elektrike të rrymës së vazhduar 10 orë
 - Qarqet e përbëra elektrike të rrymës së vazhduar 10 orë
 - Rryma tre fazore (Lidhja e pështjellave të gjeneratorit në yll dhe në trekëndësh. Lidhja e marrësve me gjeneratorin 12 orë
- c) **“Elektronikë”, kl.10 dhe “Bazat e elektronikës”, kl.11: (24 orë)**
- Dioda gjysëm përçuese 6 orë
 - Skema të thjeshta drejtuesish 6 orë
 - Tranzistorët dypolarë 6 orë
 - Qarqet bazë të tranzistorit dypolar 6 orë
- d) **“Makinat elektrike”, kl.11: (40 orë)**
- Motorrët e rrymës së vazhduar (Parimi i punës dhe ndërtimi i makinave të rrymës së vazhduar) 6 orë
 - Trasformatorët 14 orë
 - Makinat asinkrone (motorrët asinkron special) 10 orë
 - Skemat të thjeshta komandimi të motorrëve elektrike 10 orë
- e) **“Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12 dhe kl.13: (19 orë)**
- Tregu dhe sjellja konsumatore 5 orë
 - Legjislacioni i punës 5 orë

• Menaxhimi i informacionit	4 orë
• Menaxhimi i marketingut	5 orë
f) “Elektroteknikë dhe matje e thelluar”, kl. 13:	(50 orë)
• Qarqet e rrymës josinusoidale	10 orë
• Qarqet jolineare të rrymës alternative	10 orë
• Metoda simbolike për llogaritjen e qarqeve të rrymes alternative	8 orë
• Proceset kalimtare në qarqet elektrike	7 orë
• Matjet elektrike të madhësive jo elektrike	7 orë
• Aparatet matëse elektronike analoge	8 orë
f) “Elektronikë industriale”, kl.13:	(20 orë)
• Skema të ndryshme komandimi të ventilave të rregullueshëm gjysëmpërçues	14 orë
• Drejtuesit industrialë të rrymës	6 orë
f) “Administrim dhe ligjshmëri në elektroteknikë”, kl.13:	(28 orë)
• Llojet dhe format ligjore të bizneseve në fushën e elektroteknikës	2 orë
• Organizimi i punës në një biznes elektroteknik	4 orë
• Menaxhimi i veprimtarisë së një biznesi elektroteknik	6 orë
• Llogaritje të thjeshta ekonomike të punimeve të shërbimit në një biznes elektroteknik	8 orë
• Organizimi i sektorit të energjisë elektrike (organizmi i KESH, institucionet kryesore në sektorin e energjisë elektrike si METE, AKE,ERE etj.)	2 orë
• Tregu i energjisë elektrike (karakteristikat dhe skemat e modelit të tregut, zgjedhja dhe aplikimi i një modeli tregu, tregu evropian i energjisë, modeli shqiptar i tregut të energjisë elektrike)	6 orë
i) “Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm”, kl.13:	(14 orë)
• Burimet kryesore të mjedisit dhe degradimi mjedisor	4 orë
• Ndikimi i veprimtarisë së njeriut në mjedis	3 orë
• Zhvillimet demografike dhe mjedisi	4 orë
• Shoqëria e konsumit dhe mbetjet	4 orë